



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 52, datë 03/11/2004

**“PËR
ZBATIMIN E DISA DETYRAVE QË U DALIN NJËSIVE BASHKIAKE
NGA LIGJI PËR GJENDJEN CIVILE”**

Mbështetur në ligjin Nr.8950, dt.10/10/2002 “Për gjendjen civile”, neni 64, si dhe në ligjin Nr.8654, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”, neni 4, me propozimin e Kryetarit të Këshillit Bashkiak, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Zyrat e Gjendjes Civile në Njësitë Bashkiake të Tiranës hartojnë dhe mbajnë regjistrin themeltar vetëm të shtetasve që banojnë në territorin e juridiksionit të tyre përkatës.
2. Zyrat e Gjendjes Civile në Njësitë Bashkiake të Tiranës të sistemojnë regjistrin themeltar sipas pikës 1 të këtij Vendimi, brënda muajit Nëntor 2004.
3. Moszbatimi i kërkesave të pikës 1 dhe 2 të këtij Vendimi përbën shkelje dhe ndëshkohet sipas akteve ligjore në fuqi.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen organet ekzekutive të Bashkisë dhe Njësive Bashkiake të Tiranës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI